



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr 66 Date 24.7.09

PER MIRATIMIN E BILANCIT TE VITIT 2008 DHE BIZNES PLANIN E VITIT 2009

Keshilli i Bashkise se Qytetit Korce , i mbledhur sot me date 24.7.09 , pasi morri ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e "Tregut te Shitjes me Shumice te Fruta - Perimeve " Korce "Per miratimin e bilancit te vitit 2008 dhe biznes planin e vitit 2009 si dhe diskutimin dhe miratimin e raportit te Eksperteve Kontabel per kontrollin ligjor te llogarive te vitit 2008 z.Bashkim Gjata , bazuar ne ligjin Nr 8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore "neni 32 , pika dh,ne ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare "si dhe rregullave te percaktuara ne Statutin e Shoqerise , pasi shqyrtoi kete relacion te paraqitur nga Drejtoria e Shoqerise ne lidhje me bilancin e vitit 2008 dhe biznes planin e vitit 2009 mbeshtetur ne kompetencat qe ka si dhe pas diskutimit te anetareve :

VENDOSI:

1. Te miratoje madhesine e shpenzimeve te realizuara gjate vitit 2008 nga aktiviteti i Shoqerise ne masen 15 468 063 lek.
2. Te miratohet vlere e te ardhurave ne masen prej 16 465 171 lek me nje rezultat fitimi bruto ne masen prej 997 108 lek dhe mbi kete shume llogaritet Tatimi Fitimi ne masen 10 % ose ne vleren 99 711 lek Tatim Fitimi gjate vitit 2008 eshte derdhur ne buxhetin e shtetit ne formen e paradhenies.
3. Te miratohet Raporti i Ekspertit Kontabel te Autorizuar z.Bashkim Gjata
4. Per vlerat e amortizimit te llogaritur per efekt te shpenzimeve miratohet norma ligjore ne masen 5 % per ndertesat dhe 10 % per Aktivet e Tjera Afatgjata Materiale dhe kapin vleren 5 030 831 lek.
5. Per fitimin neto ne bilanc ne masen 897 397 lek , i cili do te vazhdoje ne pozicionin e caktuar te llogarise si fitime te Shoqerise mbi te cilen do te paguhet 10 % i tatimit mbi dividentin me vleren 89 740 lek.
6. Lidhur me kapitalin themeltar te Shoqerise te realizohet depozitimi akteve ne QKR
7. Te miratoje Biznes - Planin e vitit 2009
8. Per vitin ushtrimor financiar 2009 te riemerohet Eksperti Kontabel i Autorizuar z.Bashkim Gjata
9. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shoqerise se Tregut

KRYETARI I KESHILLIT

Gjergji PENDAVINI